



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 09.05.2022, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 28.04.2022.
2. Mbi shtyrjen e vendimarrjes të bordit të ERE-s për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Albesp Trading & Consulting” sh.p.k..
3. Mbi rishikimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 29, datë 14.02.2022, “Mbi ndryshimin e pjesshëm të përkohshëm të vendimit të bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.09.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “Seka Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et “Sekë” me kapacitet të instaluar 12667 kW dhe “Zais”, me kapacitet të instaluar 2295 kW, me kapacitet total të instaluar 14962 kW”.
4. Mbi licencimin e shoqërisë "Karavasta Solar" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me vendndodhje në zonën e Remasit - Karavasta, Lushnje dhe Libofshë, Fier, me kapacitet të instaluar 140 MWp.
5. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “H&K@VALA MAR Residences” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
6. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Duferco Shqipëria” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
7. Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., me nr. 372, seria F12/17, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 20.07.2012, i ndryshuar.
8. Mbi kërkesën e shoqërisë “Alb - Energy” sh.p.k., për rinovimin e licencës nr. 367, seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 65, datë 11.05.2017.
9. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 40, datë 10.03.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “Lajthiza Invest” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Qami 1”, me kapacitet të instaluar 1.730 MW”.
10. Mbi shtyrjen e vendimarrjes së bordit të ERE-s lidhur me kërkesën e shoqërisë “Hera” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës nr. 49, seria NPM07P, dhënë me vendimin e bordit nr. 61, datë 02.11.2007, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”, i ndryshuar.